



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 08.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 04.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik NSH "EL DENTAL", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje për nevoja të KPSH-se"-loti I-rë, me Nr. të Prok: 632-20-3847-1-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik NSH "EL DENTAL", e datës 04.09.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje për nevoja të KPSH-se"-loti I-rë, me Nr. të Prok: 632-20-3847-1-2-1, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të AK -së, të datës 02.09.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 02.09.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik NSH "EL DENTAL", me datë 04.09.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje për nevoja të KPSH-se"-loti I-rë, me Nr. të Prok: 632-20-3847-1-2-1

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 08.09.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- PIKA 1 - LOT 1 – Blerja e EHO – Kardiografise statike

Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD)

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Kapaciteti teknik dhe profesional

Lot I - Katalogu i nenvizuar per paisjet e ofruara me kode te prodhuesit dhe emra perkates sipas specifikacionit me ilustrime apo foto dhe me pershkrim detal te produktit me te cilin mundesohet vleresimi i specifikave teknike

-Ne katalogun e ofruar nga OE n.sh. El-Dental pjesa e specifikimeve teknike siq eshte kerkuar ne **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional** ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin per kontrate nuk eshte nenvizuar sipas specifikimeve teknike te kerkuara.

- Katalogu per UPS mungon.

- PIKA 2 - LOT 1 – Blerja e EHO – Kardiografise statike

Lot I - Blerja e EHO - Kardiografise statike

Lista e kontratave te realizuara ne 3 vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit per kontrate) (Ky Aneks eshte obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë)

- Nga OE n.sh. El-Dental nuk eshte mbushur ANEKSI Obligativ qe eshte pjese ne Dosje te tenderit faqe nr. 25

- PIKA 3 - LOT 1 – Blerja e EHO – Kardiografise statike

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Lot I - Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të cilat dëshmojnë se ka kryer furnizime të natyrës

së ngjajshme për tri vitet e fundit nga data e Lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha furnizimet e realizuara në 3 (tri) vitet e shkuara, duke saktësuar furnizimet e kryera

shumën e kontratës, datën e pranuesit ose publikimit të njoftimit për kontratë.

certifikatën e ekzekutimit të mirë të furnizimeve – (së paku një referencë ose raport të pranimit të furnizimeve e cila përputhet me listen e dorëzuar)

- Nga OE n.sh. El-Dental ne listen e kontratave te ofruara nuk posedon deshmi se ka te realizuar kontrate te natyres se ngjashme EHO-Ultraze nuk eshte ofruar as nje Reference per Ultraze per te cilen pajisje edhe behet fjale ne kete aktivitet te prokurimit.

- PIKA 4 - LOT 1 – Blerja e EHO – Kardiografise statike

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Lot I -Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar në vlerë minimale prej 80.000,00€, në 3 (tri) vitet e fundit, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% të vlerës së qarkullimit.

- Nga OE n.sh. El-Dental ne listen e kontratave te ofruara ka ofruar ne vlere prej 42.375,00 EURO ndersa jo siq eshte kerkuar ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrate.

- PIKA 5 - LOT 1 – Blerja e EHO – Kardiografise statike

Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD)

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 7.1 & 7.2

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Lot I Autorizim i leshuar nga prodhuesi - Autorizim nga prodhuesi (kopje)

- Nga OE n.sh. El-Dental nuk eshte ofruar Autorizimi nga Prodhuesi qe eshte kerkuar ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit, ne vend te saj OE n.sh. El-Dental ka ofruar nje autorizim te nje prodhuesi tjetër qe nuk perkon me katalogun e ofruar.

- **PIKA 6 - LOT 1 – Blerja e EHO – Kardiografise statike**

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

Obligimet e garancionit: **Lot I - Garancioni 12 muaj**

Shërbimet pas shitjes: **Lot I - Instalimi dhe leshuarja ne pune e aparatit, trajnimi i stafit teknik dhe mjekesor per perdorim te sistemit. (kohezgjatja sipas nevojës)**

Kushtet dhe kërkesat e dërgesës 5.3: Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës; në ditë **20**

- Nga OE n.sh. El-Dental nuk eshte ofruar Deklarata qe eshte kerkuar ne dosjen e tenderit, ne vend te saj eshte ofruar nje deklarate per lot2 qe nuk perkon me lot1.

- **PIKA 7 - LOT 1 – Blerja e EHO – Kardiografise statike**

Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË Tenderit (FTD)

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 7.1 & 7.2

Lot I - Licence valide e leshuar nga AKPM si qarkullues me shumice te produkteve dhe paisjeve medicinale

Licenca valide (kopje)

-Ne Licencen e ofruar nga OE n.sh. El-Dental pjesa e dyte pertrirja vjetore qe e verteton validitetin e licences mungon e vertetuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës

